



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI

Nr. 1586 Prot.

Tiranë, më 19.08.2026

V E N D I M

Nr. 224, Datë 19.08.2026

Bazuar në pikën 11¹, të nenit 33, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O N:

Mbështetur në nenet 32 dhe 33, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka ndjekur të gjithë hapat që parashikon procedura e hetimit administrativ, për të shqyrtuar ankesën nr. 56 Regj., datë 21.03.2024, paraqitur nga subjekti ankues z. L. M, kundër Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial³, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “*bindjeve politike*”,

Bazuar në Ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në përfundim të procedurës së hetimit, Komisioneri ka dalë me Vendimin Nr. 207, datë 22.07.2024, me anë të të cilit, ka vendosur:

¹ “Nëse Komisioneri urdhëron rregullime ose masa, personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve para Komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit. Në rast se personi, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon Komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, Komisioneri vendos masë për ndëshkimin me gjobë për personin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni”.

² Në vijim do t’i referohemi si Komisioneri ose me akronimin KMD.

³ Në vijim do t’i referohemi me akronimin ISHTI.

1. Konstatimin e diskriminimit të subjektit ankues, L. M, në të drejtën për punësim, nga ana e Inspektoratit Shtetëror, Teknik dhe Industrial (ISHTI), për shkak të konfliktit të krijuar mes tij dhe punëdhënësit, klasifikuar si “çdo shkak tjetër”.
2. Në referim të pikës 1, ISHTI, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ISHTI, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me shkresën nr. 1346 prot., datë 13.07.2026, drejtuar ISHTI-t, i kujtoi dërgimin e informacionit për zbatimin e vendimit sipërcituar.

Në referencë të detyrimit sipërcituar, ISHTI, me shkresën nr. 5732/1, datë 17.07.2026, ka njoftuar Komisionerin, se ka paraqitur ankim drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në të cilën ka kërkuar shfuqizimin e Vendimit nr. 207, datë 22.07.2024 të Komisionerit. Në këtë kërkesë padë ISHTI nuk i ka kërkuar Gjykatës marrjen e masave të sigurimit të padisë⁴ dhe çështja është në proces gjykimi. ISHTI parashtrohet se, në kushtet kur ligjshmëria e Vendimit të KMD-së është objekt i një procesi gjyqësor ende të papërfunduar, nuk mund të konsiderohet se ekziston një detyrim për zbatimin përfundimtar të tij, përpara se gjykata të jetë shprehur me vendim të formës së prerë mbi mosmarrëveshjen administrative.

Me shkresën nr. 1346/2 prot., datë 22.07.2026, Komisioneri informoi ISHTI-n se, ngritja e padisë në Gjykatën Administrative nuk përbën “ankim me efekt pezullues” në kuptim të Kodit të Procedurave Administrative, pasi neni 133, i këtij Kodi rregullon vetëm pasojat e ankimit administrativ, ndërsa ndaj Vendimit të Komisionerit lejohet vetëm ankim gjyqësor. Për rrjedhojë, paraqitja e padisë nuk ka pezulluar efektet e tij dhe vendimi ka mbetur i ekzekutueshëm.

Me shkresën nr. 5732/3 prot., datë 29.07.2026, ISHTI kërkon ndër të tjera nga Komisioneri të rivlerësojë qëndrimin e tij dhe të pushojë procedurën për vendosjen e masës administrative.

Sa më sipër, rezultoi e provuar se, ISHTI, në cilësinë e subjektit të gjetur përgjegjës për sjelljen diskriminuese, nuk ka marrë masa për zbatimin e Vendimit nr. 207, datë 22.07.2024, të Komisionerit. Në këtë mënyrë, ISHTI nuk ka përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar nga neni

⁴ Konform neneve 28 dhe 166, të Kodit të Procedurave Administrative.

33, pika 11, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar. Ky mosveprim, kjo mospërmblidhje e këtij detyrimi ligjor, në bazë të nenit 33, pika 11, të Ligjit të sipërpërmendur, shoqërohet me marrjen e masave administrative, gjobë. Për personat juridik, siç është në rastin konkret Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, në nenin 33 pika 13 të ligjit 10221/2010 parashikohet se: *“Çdo person që shkel dispozitat e këtij ligji dënohet me gjobë si më poshtë”: b) personi juridik nga 60.000 deri në 600.000 lekë;.....”*.

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi arrin në konkluzionin se, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial është në shkelje të detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin 33, pika 11, të Ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, shkelje e cila sipas parashikimeve të kësaj pike, është e dënueshme me gjobë.

Në lidhje me masën e gjobës, Komisioneri mban në konsideratë parashikimet dhe kriteret e vendosura në nenin 33, pika 12, të Ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku sanksionohet se: *“12. Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës. Nëse vendoset gjobë, komisioneri përcakton shumën e gjobës duke marrë parasysh: i) natyrën dhe fushën e veprimit të shkeljes dhe ndikimin mbi viktimën; dhe ii) rrethanat personale e financiare të shkelësit, veçanërisht duke marrë në konsideratë të gjitha burimet e të ardhurave dhe nëse shkelja kryhet nga një person juridik privat, merren parasysh aktivet e bilancit dhe fitimi, si dhe pagat totale të paguara punonjësve; c) nëse e njëjta shkelje diskriminon disa persona, vendoset vetëm një gjobë, por duke marrë parasysh kërkesat e shkronjës “b” të këtij neni”*.

Duke mbajtur në konsideratë kriteret e mësipërme për përcaktimin e masës së gjobës, Komisioneri arrin në përfundimin se, Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial duhet të gjobitet me 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, për moszbatimin e Vendimit nr. 207, datë 22.07.2024, të Komisionerit.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 32/1, shkronja “ç”, neni 33, pikat 11, 12, 13/b dhe 14, si dhe nenin 33/1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, të gjobitet në vlerën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, për moszbatimin e Vendimit Nr. 207, datë 22.07.2024, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
2. Gjoka të derdhet në Buxhetin e Shtetit, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

3. Pagesa e kësaj vlere të bëhet pranë çdo banke në llogarinë e thesarit Tiranë, për llogari të: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, NIPT: L02027451K, Kodi i institucionit përfitues: 1091001, Kodi i Degës së Thesarit: 3535, Kodi i llogarisë ekonomike: 7115499.
4. Zbatimi i Vendimit Nr. 207, datë 22.04.2024, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja dijeni për sanksionet, sjell shfuqizimin e tij.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurave Administrative, të ndryshuar.

KOMISIONER

Genta TAFA (BUNGO)